



MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL

Ministarstvo za Regionalni Razvoj - Ministry of Regional Development

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË-2023

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale



Dhjetor, 2024

ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË - 2023

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale

PËRGATITUR NGA:

Shyhrete Kastrati - Drejtoreshë e Departamentit për Performancë dhe Analiza Rajonale

Qefsere Bajrami - Udhëheqëse e Divizionit për Analiza Socio-Ekonomike Rajonale

Blinda Bytyçi - Zyrtare për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njeiti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, ministrive të linjës dhe bizneseve të sektorit privat të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve në ndikim të mjedisit biznesor.

Copyright. 2024 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë

Kati: III Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë

Tel: +383(0)38 200 64 526

<https://mzhr.rks-gov.net>

Përmbajtja:

Hyrje	5
Kapitulli I.....	6
1. Analiza për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe rajonet zhvillimore	6
1.1 Programet në mbështetje të sektorit privat nga MZHR dhe Ministrinë e Linjes për vitin 2023	8
Kapitulli II.....	9
2. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar implementuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal v.2023 ..	9
2.1 Investimet nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore në Kosovë v.2023	11
2.2 Aplikimet sipas (7) rajoneve zhvillimore.....	13
2.3 Financimi dhe bashkëfinancimi sipas (7) rajoneve zhvillimore nga PZHRB – 2023.....	15
2.4 Projektet përfituese sipas Loteve PZHRB-2023	18
2.4.1 Aplikimet sipas Lotit.....	20
2.5 Projektet përfituese sipas gjinisë PZHRB-2023.....	21
2.5.1 Aplikimet dhe përfituesit sipas gjinisë në (7) rajone zhvillimore	22
2.5.2 Bizneses përfituese sipas gjinisë dhe loteve (Start Up, Lot1 dhe Lot2).....	23
2.6 Projektet përfituese sipas përkatësisë etnike	24
2.6.1 Aplikimet sipas etnisë	25
2.7 Financimi sipas sektoreve nga programi PZHRB për vitin 2023.....	25
2.7.1 Sektori i shërbimit nga programi PZHRB për vitin 2023	28
2.7.2 Sektori i prodhimit nga programi PZHRB për vitin 2023.....	30
2.8 Punësimi.....	33
Kapitulli III	35
3. Përkrahja e sektorit privat sipas (7) rajoneve zhvillimore (PZHRB-2023).....	35
3.1 Rajoni Zhvillimor Qendër	35
3.1.1 Sektori.....	37
3.2 Rajoni Zhvillimor Veri.....	42
3.2.1 Sektori.....	45
3.3 Rajoni Zhvillimor Perendim	50
3.3.1 Sektori.....	52
3.4 Rajoni Zhvillimor Jug	57
3.4.1 Sektori.....	59
3.5 Rajoni Zhvillimor Juglindje	64
3.5.1 Sektori.....	66

3.6 Rajoni Zhvillimor Lindje	68
3.6.1 Sektori.....	70
3.7 Rajoni Zhvillimor Jugperendim	75
3.7.1 Sektori.....	77
Kapitulli IV	82
4. Përkrahja e sektorit privat sipas (7) rajoneve zhvillimore nga ML (MINT MKK dhe PZHRB v.2023)	82
4.1 Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2023 nga MINT	82
4.2 Programi për Zhvillim Rural për vitin 2023 nga MBPZHR.....	85
4.3 Programi për Sektorin Privat nga MKK.....	95
4.4 Mbështetjen e sektorit privat dhe shpërndarja e balancuar nga MHR dhe Ministrinë e Linjës.....	99
Kapitulli V	103
5. Përfundimet dhe rekomandimet	103
Burimet e informacionit:	104

Lista e Shkurtesave

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal;

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

MINT - Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim

PZHRB - Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar;

ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës;

RZHQ- Rajoni Zhvillimor Qendër;

RZHV - Rajoni Zhvillimor Veri;

RZHP- Rajoni Zhvillimor Perendim;

RZHJ - Rajoni Zhvillimor Jug;

RZHJL - Rajoni Zhvillimor Juglindje;

RZHL - Rajoni Zhvillimor Lindje;

RZHJP - Rajoni Zhvillimor Jugperendim;

Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Shtojcën 1 pika 15 e Rregullores për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Ligjin Nr.08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar si dhe Planin e Punës për vitin 2024, ka përgatitur dokumentin analitik “Analizë e Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë” për vitin 2023, bazuar në implementimin e “Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar” nga Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2023 si dhe bazuar në implementimin e programeve me ndikim në zhvillim socio-ekonomik nga Ministrinë e Linjes.

MZHR zhvillon, menaxhon dhe promovon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i MZHR-së është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes nxitjes dhe zhvillimit të ndërmarrësisë në (7) rajonet zhvillimore të Kosovës bazuar në Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritje, si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit janë disa prej synimeve specifike që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik rajonal përmes implementimit të programeve.

Në kuadër të mandatit të MZHR-së për përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar në këtë analizë trajtohet përkrahja e MZHR-së dhe ministrive tjera të linjës ndaj sektorit privat (bizneseve) bazuar në shpërndarjen dhe implementimin e programeve në (7) rajone zhvillimore sipas klasifikimit NUTS-3 të përcaktuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Ky është viti i parë që MZHR realizon analizat me ndikim socio-ekonomik në (7) rajone zhvillimore pas miratimit të Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar në Gusht të vitit 2023.

Kapitulli I

1. Analiza për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe rajonet zhvillimore

Analiza për Zhvillim Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar për vitin 2023 pasqyron shpërndarjen e financimit të projekteve në shtatë (7) rajoneve zhvillimore në Kosovë bazuar në “Nomenklaturën e Njësive Territoriale Statistikore” të përcaktuar nga Agjencia Statistike Evropiane si një sistem hierarkik i ndarjes së territorit ekonomik të Bashkimit Evropian për qëllimet e mbledhjes, zhvillimit dhe harmonizimit të rajoneve evropiane statistikore dhe analizës socio-ekonomike të rajoneve. “NUTS-1” nënkupton rajonet e mëdha socio-ekonomike tremilionë (3.000.000) deri në shtatëmilionë (7.000.000) banorë; “NUTS-2” nënkupton rajonet bazike për aplikimin e politikave rajonale tetëqindmijë (800.000) deri në tremilionë (3.000.000) banorë; si dhe “NUTS- 3” nënkupton rajonet e vogla për qëllime specifike njëqindpesëdhjetëmijë (150.000) deri në tetëqindmijë (800.000) banorë.¹

Rajon zhvillimor - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal të balancuar, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial.² Duke i'u referuar III, territori i Kosovës bazuar në këtë Kosova është e organizuar në (7) rajone zhvillimore. Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal janë: rajoni **Rajoni Qendër** me komunat: Glogoc, Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Graçanicë. **Rajoni Veri** me komunat: Mitrovicë, Mitrovicë Veriore, Leposaviç, Skënderaj, Vushtrri, Zveçan, Zubin Potok. **Rajoni Perendim** me komunat: Deçan, Istog, Klinë, Pejë. **Rajoni Jug** me komunat: Dragash, Prizren, Suharekë, Mamushë. **Rajoni Juglindje** me komunat: Kaçanik, Shtime, Shtërpçë, Ferizaj, Hani i Elezit. **Rajoni Lindje** me komunat: Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Viti, Ranillug, Partesh, Klllokot. **Rajoni Jugperendim** me komunat: Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik.³

¹ Ligji NR. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar

² Ligji NR. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar

³ Ligji NR. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar

SHTATË (7) RAJONET ZHVILLIMORE NË KOSOVË



1.1 Programet në mbështetje të sektorit privat nga MZHR dhe Ministritë e Linjes për vitin 2023

Roli dhe fuqizimi i sektorit privat përmes rritjes së produktivitetit, ruajtjes së konkurrencës dhe sjellja e vlerës së shtuar në vendin tonë është shumë i rëndësishëm për ekonominë e tregut. Duke u bazuar në mandatin ligjor dhe buxhetin e aprovuar me ligjin vjetor të buxhetit, disa prej Ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës zhvillojnë dhe realizojnë programe në përkrahje sektorit privat duke financuar kështu implementimin projekteve të bizneseve. Viti 2023 është viti i gjashtë që Ministria e Zhvillimit Rajonal implementon programin në mbështetje të sektorit privat bizneseve përmes “Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)”.

Ministria e Zhvillimit Rajonal është përcaktuar përgjegjëse për zbatimin dhe për mbështetjen e programeve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal të balancuar. MZHR mbështet bizneset në sektorin e prodhimit dhe sektorin e shërbimeve konform buxhetit të aprovuar dhe të paraparë për realizimin e këtyre programeve. Duke u bazuar në ngjashmërinë e programeve lidhur me kualifikueshmerinë e llojeve të bizneseve (mikro, të vogla dhe të mesme) dhe sektorëve (prodhim dhe shërbim) në të cilët janë përkrahur bizneset nga ministritë e linjës për vitin 2023, në këtë analizë janë shtjelluar edhe thirrjet për mbështetje të bizneseve të financuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë MINT, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MBPZHR. Këtë vit është pasqyruar edhe programi i mbështetjes së sektorit privat edhe nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Zgjerimi i kapaciteteve biznesore, gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e eksportit zëvendësimi i importit, janë synimet kryesore të katër (4) programeve. Në këtë analizë realizimi i programeve për përkrahjen e bizneseve për v.2023 është trajtuar sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore përfshirë:

- *Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2023) realizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR);*
- *Programi për përkrahjen e NMVM-ve v.2023, i realizuar nga KIESA/MINT;*
- *Programi për subvencionim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2023;*
- *Programi në mbështetje të sektorit privat 2023 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.*

Kapitulli II

2. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar implementuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal v.2023

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së Granteve për biznese e shpërndarë në tre (3) lote. Synim kryesor i kësaj skeme është që të mbështesë sa më shumë projekte cilësore me ndikim në zhvillim socio-ekonomik të balancuar sipas rajoneve zhvillimore. Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes udhëzuesëve për aplikantë dhe përfitues të granteve parasheh të gjitha udhëzimet, rregullat dhe procedurat tjera të aplikimit si dhe implementimit të projekteve. Gjatë vitit 2023 MZHR ka implementuar “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar” i cili është realizuar përmes skemës së granteve për mbështetje financiare ndaj bizneseve. Përmes kësaj skeme MZHR mbështet bizneset mikro dhe të vogla, ndihmon bizneset në plotësimin e nevojave të tyre për të bërë biznes, zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese. MZHR përmes partnerëve ndërkombëtar si (BERZH, UNICEF, GIZ, USAID, CARITAS etj), ka arritur të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitet e tyre prodhuese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjatë të funksionimit. Gjithashtu MZHR bashkë me partnerët e saj ka realizuar trajnime profesionale në ngritjen e kapaciteteve të tyre humane, menaxhuese, menaxhim financiar etj. Ministria e Zhvillimit Rajonal mban rregullisht sesione informuese për aplikantët potencial/bizneset për formën e aplikimit si dhe sesione informuese për implementimin e projekteve. Sesionet informuese realizohen rregullisht në bashkëpunim me AZHR-të në rajonet zhvillimore në të cilat operon MZHR.

Skema e Granteve PZHRB (2023) inkurajon aplikime me projekte inovative nga gratë dhe të rinjtë dhe komunitetet jo shumicë të aplikojnë në kuadër të kësaj skeme. Rëndësi e veçantë i është kushtuar fuqizimit të bizneseve në sektorin e prodhimit si faktor kyç i zhvillimit ekonomik duke mundësuar hapjen e vendeve të reja të punës dhe duke ndikuar kështu në uljen e papunësisë. Përkufizimi lotëve sipas thirrjes së PZHRB (2023) dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon: Start up - Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €; Lot 1 – Biznes ekzistues - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla Nga 5,001.00 € deri në 15,000.00 €; Lot 2 – Biznes ekzistues – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla Nga 15,001.00 – 25,000.00 €. Disa prej ndikimeve që ka pasur implementimi I Programit për Zhvillimi Rajonal të Balancuar që janë paraqitur si mëposhtë:

Figura 1. Ndikimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Hapja bizneseve të reja Start Up: përmes nxitjes së ndërmarrësve të rinj; zhvillimi i ideve të reja e creative; Zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve përfituese: përmes krijimit të infrastrukturës; Ndikimi i mbështetjes përmes paisjeve: cilësi në prodhim/shërbim; makineri me programe moderne, të shpejta; Hapjen e vendeve të reja të punës: krijimit të infrastrukturës për vetpunësim dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës; Ndikimit në treg përmes: ndikimit në rritjen e prodhimit, përmirësimin të shërbimit, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të importit; Rritja e grave ndërmarrëse përmes mbështetjes nga skema e granteve të PZHRB-së duke inkurajuar ato në hapjen e bizneseve dhe nxitjen e ndërmarrësisë në sektor të ndryshëm. Në analizën për zhvillimin socio- ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë për vitin 2023 nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar janë trajtuar: numri i aplikimeve të bizneseve sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore dhe komunave; numri i përfituesve (bizneseve) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore dhe komunave; vlera financiare e financimit për bizneset përfituese; vlera e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese; sektorët përfitues më të financuar sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore; numri i vendeve të reja të punës të krijuara nga bizneset përfituese; numri i përfituesëve sipas Loteve të mbështetura nga Programi (PZHRB); numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike sipas rajoneve zhvillimore; numri


i përfituesve sipas gjinisë sipas rajoneve zhvillimore; komunat që kanë përfituar më së shumti projekte sipas rajoneve zhvillimore dhe komunat që nuk kanë qenë përfituese.

Thirrja për Grante e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB nga MZHR për vitin 2023 sipas udhëzuesit është hapur dhe implementuar sipas pesë rajoneve zhvillimore bazuar në programet të BE-së, pasi që Ligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar nuk ishte në fuqi. Ndërkaq në këtë analizë pasqyrimi i shpërndarjes së subvencioneve nga programi PZHRB-së e realizuar për vitin 2023 është bërë sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore bazuar në Ligjin për Zhvillim Rajonal.

2.1 Investimet nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar në shtatë (7) rajonet zhvillimore në Kosovë v.2023

Sipas të dhënave të implementimit nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 në (7) rajonet zhvillimore janë përkrahur gjithsej (131) projekte dhe janë krijuar 274 vende të reja të punës. Gjithsej vlera totale financiare e projekteve të implementuara për vitin 2023 është 1,563,002.80 € ku në kategorinë Start Up janë financuar 60 projekte në vlerën 280,652.80 €, në kategorinë Lot1 janë financuar 36 projekte në vlerë 477,099.00 € dhe Lot 2 janë financuar 35 projekte në vlerën 805,251.00 €. Në kuadër të Skemes së Granteve PZHRB-2023 janë pranuar 1644 aplikime nga pesë (7) rajonet zhvillimore nga të cilat 792 aplikime janë pranuar në Start Up kategorinë, 571 aplikime në kategorinë Lot 1 dhe 281 aplikime në kategorinë Lot 2. Nëse krahasojmë vlerën e përgjithshme të shpërndarjes së investimeve nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar i vitit 2022 kemi një rënie të vlerës së financimit prej 48 % dhe 61% të përkrahjes së numrit të projekteve nga ky program për vitin 2023.

Figura 2. Investimet nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2022-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Skema e Granteve bazuar në “Programin Zhvillimor Rajonal të Balancuar” gjatë vitit 2023, ka mbështetur gjithsej (131) projekte të cilat janë shpërndarë në shtatë (7) rajone zhvillimore:

- **Në rajonin Qendër** (Komuna e Prishtinës me komunat përreth), janë përkrahur **(25)** projekte;
- **Në rajonin Veri** (Komuna e Mitrovicës me komunat përreth), janë përkrahur **(25)** projekte;
- **Në rajonin Perendim** (Komuna e Pejës me komunat përreth), janë përkrahur **(14)** projekte;
- **Në rajonin Jug** (Komuna e Prizrenit me komunat përreth), janë përkrahur **(26)** projekte;
- **Në rajonin Juglindje** (Komuna e Ferizajt me komunat përreth), **(4)** projekte;
- **Në rajonin Lindje** (Komuna e Ferizajt me komunat përreth), **(22)** projekte;
- **Në rajonin Jugperendim** (Komuna e Ferizajt me komunat përreth), **(15)** projekte.

Figura 3. Përfituesit nga Skema e Granteve PZHRB-2023

Përfituesit në % sipas numrit të projekteve (2023)




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.2 Aplikimet sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore

Në kuadër të Skemës PZHRB – 2023 nga shtatë (7) rajone zhvillimore përfshirë kategorinë *Start up*, *Lot 1* dhe *Lot 2* kanë aplikuar gjithsej 1644 prej tyre biznese ekzistuese dhe biznese në themelim. Rajoni Qendër ka pasur numrin më të madh të aplikimeve për vitin 2023 duke vijuar me rajonin e Jugut, rajonin e Veriut, rajonin e Lindjes, rajonin e Juglindjes, rajonin e Jugperendimit dhe Perendimit.


Figura 4. Përfituesit nga Skema e Granteve PZHRB në (7) rajone zhvillimore v.2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 5. Aplikimet nga Skema e Granteve PZHRB në (7) rajone zhvillimore v.2023

Aplikimet në % në (7) rajone zhvillimore (2023)



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.3 Financimi dhe bashkëfinancimi sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore nga PZHRB – 2023

Në tabelën nr.1 janë paraqitur vlerat totale të financimit dhe bashkëfinancimit për secilin rajon zhvillimor duke pasqyruar vlerat financiare për secilin rajon. Gjithsej vlera totale e financimit dhe bashkëfinancimit të (131) projekteve nga Skema e Granteve PZHRB për vitin 2023 në (7) rajone zhvillimore ka arritur vlerën prej 2,220,982.66 €uro. Në tabelën vijuese është paraqitur vlera e financimit nga MZHR dhe e bashkëfinancimit në shtatë rajone zhvillimore si dhe pjesmarrja në % e secilit rajon në totalin e financimit dhe bashkëfinancimit.


Tabela 1. Vlera e financimit dhe bashkëfinancimit nga Skema e Granteve PZHRB-2023

TOTALI I VLERAVE TE FINANCIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT SIPAS RAJONEVE EKONOMIKE - PZHRB 2023				
RAJONET SOCIO-EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT-PZHRB 2023 (€)	%	VLERA E BASHKËFINANCIMIT NGA BIZNESET PZHRB 2023 (€)	%
Rajoni Zhvillimor Jug	255,844.90 €	16%	111,016.80 €	17%
Rajoni Zhvillimor Jugperendim	189,253.00 €	12%	79,188.08 €	12%
Rajoni Zhvillimor Perendim	188,401.00 €	12%	85,373.00 €	13%
Rajoni Zhvillimor Qendër	321,406.00 €	21%	138,807.00 €	21%
Rajoni Zhvillimor Juglindje	40,000.00 €	3%	13,716.98 €	2%
Rajoni Zhvillimor Lindje	271,126.00 €	17%	113,872.26 €	17%
Rajoni Zhvillimor Veri	296,971.90 €	19%	116,005.74 €	18%
GJITHSEJ:	1,563,002.80 €	100%	657,979.86 €	100%

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Në grafikun nr.2 është paraqitur në % shpërndarja e mjeteve financiare sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar mbështetje në sektorin privat për vitin 2023. Bazuar në % e vlerave të implementimit të projekteve vërejmë që 21% e vlerës totale apo 321,406.00 € e vlerës financiare është implementuar në rajonin Qendër, duke vijuar me rajonin e Veriut me 19% të vlerës totale, rajonin e Lindjes me 17% të vlerës totale, rajoni i Jugut me 16%, rajoni i Perendimit me 12%, rajoni i Jugperendimit me 12%, dhe rajoni i Juglindjes me rreth 3% të vlerës totale dhe njëherit rajoni me vlerën më të vogël të investuar nga MZHR.

Figura 6. Vlera e financimit nga Skema e Granteve PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Bazuar në mesataren e diskrepancës mesatarisht ka pasur pasur investime 14.2% për rajon ndërkaq mospërputhja e financimit ndërmjet (7) rajoneve zhvillimore është 4.5%. Vlen të theksohet që ndarja e financimit sipas komisionit të vlerësimit është bërë bazuar në balancimin e pesë rajoneve zhvillimore, ndërkaq këto të dhëna për tu analizuar janë transformuar në (7) rajone zhvillimore gjë e cila mund të ndikojë në rritjen e mospërputhjes së financimit të rajoneve për shkak që ka ndryshuar numri i komunave pjesmarrëse brenda rajonit duke rritur apo zvogëluar numrin e komunave.

Në grafikun vijues është paraqitur vlera e financimit dhe bashkëfinancimit nga bizneset përfituese nga Skema e Granteve PZHRB-2023 përfshirë tre lotet Start Up, Lot 1 dhe Lot 2. Për kategorinë START-UP përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët ka qenë nga 10% deri në 40% kurse shuma e kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal ka qenë mbi 60% e kostos totale të projekt propozimit; Për kategorinë LOT 1 – biznes ekzistues përqindja e bashkëfinancimit nga përfituesit minimumi 30% dhe maksimumi 40% kurse shuma e kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal mbi 60% e kostos totale të projekt propozimit; Për kategorinë LOT 2 – biznes ekzistues përqindja e bashkëfinancimit nga përfituesit ka qenë minimumi 30% dhe maksimumi 40% kurse shuma e kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal jo më pak se nën 60% e kostos totale të projekt propozimit.⁴

Figura 7. Financimi dhe bashkëfinancimi nga Skema e Granteve PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

⁴ Udhëzuesi për Aplikantët e Granteve Pzhrb-2023

2.4 Projektet përfituese sipas Loteve PZHRB-2023

Në vitin 2023 Skema e Granteve nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar është shpërndarë në tre Lote. Në lotin Start Up kanë përfituar gjithsej 60 biznese, në Lotin 1 kanë përfituar gjithsej 36 biznese dhe në Lotin 2 kanë përfituar gjithsej 35 biznese. Për nga numri i projekteve kemi Lotin Start Up me 60 projekte përfituese ku kemi edhe numri më të madh të aplikimeve ndërsa nga vlera e financimit Lot 2 është kategoria më e financuar nga Skema e Granteve PZHRB 2023 me gjithsej 805,251.00 Euro për projektet përfituese.


Tabela 2. Financimi dhe bashkëfinancimi nga Skema e Granteve PZHRB-2023

VLERA E FINANCIMIT DHE NUMRI I PROJEKTEVE SIPAS LOTEVE PZHRB 2023								
RAJONE T SOCIO- EKONO MIKE	NUMRI I PROJE KTEVE (START UP)	VLERA E FINANCIM IT (START UP)	RAJON ET SOCIO- EKONO MIKE	NUMRI I PROJEK TEVE (LOT1)	VLERA E FINAN CIMIT (LOT1)	RAJON ET SOCIO- EKONO MIKE	NUMRI I PROJEK TEVE (LOT2)	VLERA E FINAN CIMIT (LOT2)
Rajoni Jug	12	€ 53,634.90	Rajoni Jug	8	€ 89,810.0 0	Rajoni Jug	6	€ 112,400. 00
Rajoni Jugperen dim	7	€ 32,232.00	Rajoni Jugperen dim	3	€ 33,660.0 0	Rajoni Jugperen dim	5	€ 123,361. 00
Rajoni Perendim	5	€ 24,860.00	Rajoni Perendi m	4	€ 55,351.0 0	Rajoni Perendi m	5	€ 108,190. 00
Rajoni Qendër	11	€ 52,204.00	Rajoni Qendër	7	€ 99,452.0 0	Rajoni Qendër	7	€ 169,750. 00
Rajoni Juglindje	3	€ 15,000.00	Rajoni Juglindje	0	0	Rajoni Juglindje	1	€ 25,000.0 0
Rajoni Lindje	10	€ 48,180.00	Rajoni Lindje	7	€ 97,946.0 0	Rajoni Lindje	5	€ 125,000. 00
Rajoni Veri	12	€ 54,541.90	Rajoni Veri	7	€ 100,880. 00	Rajoni Veri	6	€ 141,550. 00
Gjithsej	60	280,652.80 €	Gjithsej	36	€ 477,099. 00	Gjithsej	35	€ 805,251. 00

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal


Financimi i projekteve dhe numri i projekteve përfituese sipas tre loteve nga Skema e Granteve PZHRB-2023.

Figura 8. Financimi sipas loteve Skema e Granteve PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 9. Vlera e financimit në (%) sipas Loteve (Start Up, Lot 1 dhe Lot2) PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.4.1 Aplikimet sipas Lotit

Aplikimet më të mëdha nga Skema e Granteve PZHRB edhe në vitin 2023 mbeten në Lotin Start Up (*biznese në themelim*), ku kërkesa më e lartë në këtë kategori mbeten moshat e reja. Lot 2 është kategoria e dytë më e kërkuar sipas aplikimeve ndërkaq Lot1 mbetet kategoria më pak atraktive dhe e kërkuar nga Skema e Granteve PZHRB.

*LOT 1 – Biznese ekzistuese përfshinë ndërmarrjet mikro dhe të vogla me një qarkullim prej 2,000.00€ deri në 29,999.99€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK; Shuma e granteve nga 5,001.00 €deri në 15,000.00 €;*⁵

Figura 10. Vlera e financimit në (%) sipas Loteve (Start Up, Lot 1 dhe Lot2) PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Aplikimet në kategorinë Start Up që nga viti i parë i implementimit të programit për zhvillim rajonal të balancuar është kategoria me kërkesën më të madhe për aplikim të projekteve. Gjithsej numri i aplikimeve që nga viti 2018 deri në vitin 2023 ka arritur në shifrën prej 5077 aplikuesish. Gjithashtu nga MZHR kategoria Start Up mbetet kategoria më e përkrahur sa i përket numrit të projekteve. Sfidë mbetet qëndrueshmëria e këtyre projekteve për shkak të shumë faktorëve të brendshëm siç janë kostoja e lartë e paisjeve dhe vlera jo e mjaftueshme e grantit si dhe mjedisi biznesor, nevoja e rritjes profesionale si dhe njohja e tregut.

⁵ Udhëzuesi për Aplikantë PZHRB-2023

2.5 Projektet përfituese sipas gjinisë PZHRB-2023

Ministria për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka inkuruar gjithmonë gratë që të jenë pjesë e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Në tabelën vijuese janë paraqitur përfituesit sipas gjinisë në (7) rajonet zhvillimore nga PZHRB për vitin 2023.


Tabela 3. Financimi sipas gjinisë nga Skema e Granteve PZHRB-2023

Perfituesit sipas (7) rajoneve zhvillimore PZHRB 2023	Rajonet	Numri I përfitueseve (Gra)	%	Numri I përfituesve (Burra)	%
	Jug	10	21%	16	19%
	Jugperendim	7	15%	8	10%
	Perendim	6	13%	8	10%
	Qendër	8	17%	17	20%
	Juglindje	3	6%	1	1%
	Lindje	6	13%	16	19%
	Veri	7	15%	18	21%
	Gjithsej	47	100%	84	100%

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal


Në vitin 2023 MZhR në total ka mbështetur financiarisht (47) biznese apo 36% të bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe (84) biznese të udhëhequra nga burrat apo 64% të projekteve në tre lotet (Start Up, Lot1 dhe Lot2).

Figura 11. Përfituesit sipas gjinisë Skema e Granteve PZHRB 2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 12. Aplikuesit sipas gjinisë Skema e Granteve PZHRB 2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.5.1 Aplikimet dhe përfituesit sipas gjinisë në (7) rajone zhillimore


Bazuar në grafikun nr. 13 aplikimet në Skemën e Grantve PZHRB-2023 sipas gjinisë, përqindja më e madhe e tyre ka qenë nga burrat me rreth 61% të aplikimeve duke vijuar me grate me pjesmarrje prej 39% të aplikimeve në (7) rajonet zhvillimore në Kosovë.

Figura 13. Përfituesit sipas gjinisë Skema e Granteve PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 14. Aplikimet sipas gjinisë në (7) rajone zhvillimore në Kosovë:



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.5.2 Bizneset përfituese sipas gjinisë dhe loteve (Start Up, Lot1 dhe Lot2)

Në tabelën nr.4 janë pasqyruar numri dhe vlera e financimit të projekteve përfituese nga grate dhe burrat nga PZHRB sipas Loteve Start Up, Lot1 dhe Lot2 për vitin 2023.

Tabela 4. Bizneset përfituese sipas gjinisë dhe loteve PZHRB-2023

Gjinia më e përfaqësuar në shtatë (7) rajone zhvillimore	Grua			Burrë		
	Numri i projekteve përfituese	%	Vlera financiare e investuar	Numri i projekteve përfituese	%	Vlera financiare e investuar
Start Up	33	70%	€ 153,635.20	27	32%	€ 127,017.60
Lot 1	8	17%	€ 91,216.00	28	33%	€ 385,883.00
Lot 2	6	13%	€ 139,900.00	29	35%	€ 665,351.00
Gjithsej	47	100%	€ 384,751.20	84	100%	€ 1,178,251.60

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Në vitin 2023 gratë kanë numrin më të madh të projekteve përfituese në kategorinë Start Up nga programi PZHRB me gjithsej 33 projekte përfituese apo 55% të totalit nga kategoria Start Up në krahasim me burrat me 27 numër të projekteve apo 45%. Ndërkaq në Lot1 dhe Lot 2 burrat kanë numrin më të madh të projekteve nga ky program.

2.6 Projektet përfituese sipas përkatësisë etnike


Bazuar në Skemën e Granteve PZHRB-2023, përqindja më e madhe e përfituesëve ka qenë nga përkatësia etnike shqiptar me 91% të projekteve duke vijuar me turk 5%, boshnjak 1%, serb 2%, rae 1% në (7) rajonet zhvillimore në Kosovë.

Tabela 5. Bizneset përfituese sipas përkatësisë etnike PZHRB-2023

Rjonet zhvillimore	Përkatësia etnike	Numri i projekteve	%	Vlera financiare nga MZHR	%
Shtatë (7) rajonet zhvillimore	Shqiptar	119	91%	€ 1,407,972.80	90%
	Turk	7	5%	€ 83,780.00	5%
	Boshnjak	2	1%	€ 9,250.00	1%
	Rom, Ashkalinj Egjiptian	1	0%	€ 22,000.00	1%
	Goran	0	0	0	0
	Serb	2	2%	€ 40,000.00	3%
	Gjithsej	131	100%	€ 1,563,002.80	100%

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 15. Bizneset përfituese sipas përkatësisë etnike PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.6.1 Aplikimet sipas etnisë

Bazuar në grafikun nr. aplikimet në Skemën e Granteve PZHRB-2023 sipas etnisë, përqindja më e madhe e aplikimeve ka qenë nga përkatësia etnike shqiptar me 94% të aplikimeve duke vijuar me turk 2%, boshnjak 2%, serb 2% të aplikimeve në (7) rajonet zhvillimore në Kosovë ndërsa pjesmarrja e aplikimeve të përkatësisë goran, rae dhe të tjera mbetet ende e ulët duke filluar nga (0.06%-0.42%) të aplikimeve në (7) rajonet zhvillimore në Kosovë.

Figura 16. Aplikimet sipas përkatësisë etnike PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.7 Financimi sipas sektoreve nga programi PZHRB për vitin 2023

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Skemës së Granteve nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur çdo vit dy sektorë të rëndësishëm me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik në Kosovë. Përmes kësaj skeme MZHR është munduar që të fuqizojë sektorin e prodhimit përmes mbështetjes së sektorit privat bizneseve. Krahësuar me implementimin e programit PZHRB 2022 implementimi i programit shënon një progres të jashtëzakonshëm në këtë drejtim. Bazuar në të dhënat e bizneseve përfituese sektori i prodhimit është mbështetur me rreth 70% të vlerës financiare nga totali i vlerës 1,563,002.80 € së PZHRB-së duke financuar rreth me 66 biznese përfituese në këtë sektor si dhe me 30 % të vlerës totale financiare në sektorin e shërbimit

me rreth 65 biznese përfituese. Kjo ka ndodhur pas strategjisë së përdorur nga MZHR për të fuqizuar më shumë sektorin e prodhimit ku kategoria Lot 2 e kësaj thirrje i është dedikuar i tëri sektorit të prodhimit vetëm për bizneset që segment të veçantë e kanë prodhimin. Vlera e financimit nga MZHR në LOT 2 – Biznes ekzistues – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla ka qenë 15,001.00 – 25,000.00 €.

Figura 17. Sektori më i financuar nga Skema PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Tabela 6. Bizneset përfituese sipas sektorit në (7) rajone zhvillimore Skema PZHRB-2023

Sektori	Nr. Projekteve	Prodhim	Nr. Projekteve	Shërbim
Rajoni Jug	16	200,637.80 €	10	55,207.10€
Rajoni Jugperendim	7	139,111.00 €	8	50,142.00 €
Rajoni Perendim	7	124,690.00 €	7	63,711.00 €
Rajoni Qendër	9	186,250.00 €	16	135,156.00€
Rajoni Juglindje	2	35,000.00 €	2	5,000.00€
Rajoni Lindje	12	199,900.00€	10	71,226.00€
Rajoni Veri	13	212,711.80€	12	84,260.10€
Gjithsej	66	1,098,300.60 €	65	464,702.20 €

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal


Figura 18. Sektori më i financuar në (7) rajone zhvillimore nga Skema PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Nëse krahasojmë financimin e sektorëve të Skemës së Granteve të Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB nga viti 2022 dhe 2023 vërejmë që në vitin 2023 kemi një balancim të dy sektorëve sa i përket mbështetjes së sektorit privat bizneseve me 50% të mbështetjes së projekteve në sektorin e prodhimit dhe 50% të projekteve në sektorin e shërbimit. Ndërkaq në vitin 2022 nga Skema PZHRB nga sektori i prodhimit janë mbështetur 39% e projekteve ndërsa nga sektori i shërbimit 61% e projekteve. Nga kjo vërejmë që kemi një balancim rreth 11% të sektorit të prodhimit dhe të shërbimit nga viti 2022.

Figura 19. Sektori më i financuar nga Skema PZHRB 2022-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.7.1 Sektori i shërbimit nga programi PZHRB për vitin 2023

Bazuar në shpërndarjen e Skemës së Granteve PZHRB për vitin 2023 përfshirë (7) rajonet zhvillimore në Kosovë veprimtaritë më të financuara në kuadër të sektorit të shërbimit janë: *rrobaqepësi/fashion design 19%; shërbime të inxhinierisë, arkitekturës, gjeodezisë, këshillimit teknik 13%; shërbime dizajn grafik, programim/IT 13%; mirmbajtje dhe pastrim të veturave 10%; shërbime estetike 10%.* Ndërkaq pjesa tjetër tek të tjera (*gastronomi, shërbime kontabiliteti, marketing, fotografi, inçizime, shërbime të personalizuar etj.*) përbëjnë 35% të veprimtarive në kuadër të këtij sektori.

Figura 19. Sektori i shërbimit sipas veprimtarive nga Skema PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Ndërkaq në kuadër të loteve (Start Up, Lot1 dhe Lot2) në kategorinë Start Up kemi këto veprimtari më të shprehura në kuadër të sektorit të shërbimit: *rrobaqepësia me 24% të projekteve ku korrespondon edhe me numrin më të madh të përfituesëve femra në këtë lot me rreth 55% të projekteve përfituese në kuadër të skemës së granteve PZHRB-2023. Shërbime të inxhinierisë, arkitekturës, gjeodezisë, këshillimit teknik me 17%; Shërbime të dizajnit grafik, programim/IT 13%; sallone bukurie 13%; dhe të tjera si (shërbime kontabiliteti, shërbime dixhitale, gastronomi etj) me 33%.*





Figura 20. Sektori i shërbimit Start Up, PZHRB-2023

Në kategorinë Lot1 në Skemën e Granteve PZHRB për vitin 2023, ndër veprimtaritë më të financuara janë: *mirëmbajtje, pastrim dhe riparim të automjeteve 23%; shërbime të ushqimit 18%; marketing 12%; shërbime të dizajnit grafik dhe teknologjisë informative 12%; dhe të tjera 35%.*


Figura 21. Sektori i shërbimit Lot 1, PZHRB-2023



2.7.2 Sektori i prodhimit nga programi PZHRB për vitin 2023

Bazuar në shpërndarjen e Skemës së Granteve PZHRB për vitin 2023 përfshirë (7) rajonet zhvillimore në Kosovë veprimtaritë më të financuara në kuadër të sektorit të prodhimit janë: *përpunim i ushqimit 27%; prodhime të plastikës dhe gomës 13%; përpunim i drurit 12%; prodhime nga tekstili 11%. Ndërkaq pjesa tjetër tek të tjera (prodhim nga betoni, guri, graniti, pije, qeramike etj.) me rreth 37%.*


Figura 22. Sektori i prodhimit, PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal


Ndërkaq në kuadër të loteve (Start Up, Lot1 dhe Lot2) në kategorinë Start Up kemi këto veprimtari më të shprehura në kuadër të sektorit të prodhimit: *prodhim dhe përpunim i ushqimit i (bukës, ëmbëlsirave) me 50% të projekteve; prodhim dhe përpunim i tekstileve 36%; prodhim i produkteve metalike 14%;*

Figura 23. Sektori i prodhimit Start Up, PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal


Figura 24. Sektori i prodhimit Lot1, PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Kategoria Lot 2 nga skema e Granteve PZHRB për vitin 2023 ka qenë e dedikuar vetëm për sektorin e prodhimit me qëllim të mbështetjes së këtij sektori për rritjen e prodhimit. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur veprimtaritë më të financuara në kuadër të këtij sektori: zdrukthtaria dhe përpunimi i produkteve nga druri 18% është mbështetur më së shumti; përpunimi i produkteve nga plastika dhe goma 17%, duke vijuar me sektorin e tekstileve 11%; përpunim i ushqimit 11%; produkte nga letra 9% si dhe tek të tjera kemi 34% të projekteve të mbështetura në kuadër të kësaj skeme.

Figura 25. Sektori i prodhimit Lot2, PZHRB-2023



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

2.8 Punësimi

MZHR përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar përmes mbështetjes së bizneseve ka për qëllim dhe rritjen e punësimit tek të rinjtë dhe stimulimin e projekteve të qëndrueshme. Në kuadër të kësaj Skeme në bazë të planifikimit të punësimit nga 131 projekte biznese përfituese kanë qenë të planifikuar të punësohen rreth 315 persona gjatë implementimit të projektit në vitin e parë, ndërsa deri më tani v.2024 janë punësuar 274 persona në (7) rajonet zhvillimore në Kosovë të dëshmuar në ATK nga bizneset përfituese të kësaj skeme.⁶

Tabela 7. Numri i të punësuarëve sipas (7) rajoneve zhvillimore Skema PZHRB-2023


RAJONET ZHVILLIMORE	Gjithsej të punësuar	Start Up	Grua	Burrë	Lot 1	Grua	Burrë	Lot 2	Grua	Burrë
RAJONI ZHVILLIMOR QENDËR	42	15	8	7	12	8	4	15	1	14
RAJONI ZHVILLIMOR VERI	58	22	11	11	17	5	12	19	5	14
RAJONI ZHVILLIMOR PERENDIM	29	6	6	0	10	8	2	13	6	7
RAJONI ZHVILLIMOR JUG	57	24	10	14	14	3	11	19	8	11
RAJONI ZHVILLIMOR JUGLINDJE	15	11	5	6	0	0	0	4	0	4
RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE	39	6	2	4	17	4	13	16	2	14
RAJONI ZHVILLIMOR JUGPERENDIM	34	13	7	6	6	2	4	15	5	10
GJITHSEJ	274	97	49	48	76	30	46	101	27	74

Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Bazuar në statistikat e nxjerra nga Skema PZHRB e vitit 2023, numri më i madh i të punësuarëve i takon rajonit të Prizrenit dhe Mitrovicës me rreth 21% për secilin rajon nga totali i të punësuarëve. Ndërsa sa i përket lotit brenda këtij programi, numri më i madh i të punësuarëve është në Lotin 2 me 37% të punësuarëve ku kjo kategori ka qenë e dedikuar për sektorin e prodhimit. Bazuar në gjininë e të punësuarëve nga kjo Skemë burrat përfshijnë përqindjen më të madhe të të punësuarëve me 61% ndërsa gratë 39%.


⁶ ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 26. Punësimi sipas rajoneve (7) rajoneve zhvillimore PZHRB-2023




Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 27. Puensimi sipas lotit



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Figura 28. Punesimi sipas gjinise



Burimi: Ministria e Zhvillimit Rajonal

Kapitulli III

3. Përkrahja e sektorit privat sipas (7) rajoneve zhvillimore (PZHRB-2023)

3.1 Rajoni Zhvillimor Qendër

Rajoni Zhvillimor Qendër përfshinë shtatë (7) Komuna: (Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Podujevë, Obiliq dhe Lipjan). Nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar në Rajonin Zhvillimor Prishtinë, janë përkrahur gjithsej:

- **25 (njëzetë e pesë) biznese në vlerë prej 321,406.00€;**

Në kuadër të Skemës së Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar në rajonin Qendër shpërndarja e bizneseve përfituese sipas loteve ka qenë si vijon:


- **Në Lot1 (Start up) janë financuar 11 projekte;**
